

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Komuna e Glllogoc**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **611-25-2935-5-2-1**

Nr i brendshëm: 611-25-033-521

Sa i përket tenderit me titull:

Ndërtimi i rrugëve fushore ne Komun-Drenas, Komoran, Terstenik, Doborshec, Baicë dhe Arllat–projekt dy vjeçar ” - e ndare ne dy loto Asfaltimi i rrugve ne Terstenik I,II dhe Glllobar–projekt tre vjeçar

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	"M.Shala FA" sh.p.k
NUI	812101955
Adresa	Rruga: Fehmi Lladrovci, nr.11
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	044166063
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Faton Shala
Adresa elektronike	m.shalashpk@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	26.04.2025



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit: F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK lidhur me aktivitetin e prokurimit: A Ndërtimi i rrugëve fushore në Komun-Drenas, Komoran, Terstenik, Doborshec, Baicë dhe Arllat–projekt dy vjeçar ” - e ndare në dy loto Asfaltimi i rrugëve në Terstenik I,II dhe Glllobar–projekt tre vjeçar

Për Aktivitetin e Prokurimit: **611-25-2935-5-2-1**

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. B05 Njoftim për Kontratë dt 10.04.2025
2. B05 Njoftimi për informata shtesë ose përmirësim i gabimit dt 17.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo ☒

	Arsyetimi: Nuk është bërë akoma hapja
--	--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo ☒

Arsyetimi: Nuk është bërë akoma hapja e tenderit.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me dt 17.04.2025 Duke par padrejtësitë dhe diskriminim në kritere që na u është bërë kompanive jem të detyruar Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të ju drejtohem AK Komunës së Glllogoc me Kërkesë për Rishqyrtim.

Sqarim: Kërkesa për Rishqyrtim bazohet në kriteret e njoftimit të kontratës dhe dosjes së tenderit

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Sipas “M.SHALA FA” sh.p.k , AK janë te pa përgjegjshëm duke shkelur NENET si me poshtë:

Neni 1- Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Të pa kënaqur me Vendimin e AK Komuna e Glllogoc në pajtim me nenin 108A të LPP-s parashtrojmë kërkesë për Rishqyrtim Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK

AK Komuna e Glllogoc ka ber shkelje ne Neni 7:

- 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*
- 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.*

AK Komuna e Glllogoc ka ber shkelje ne Neni 56

- 4. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:*
- 5. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;*
 - 1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.*

Mos pajtimet lidhur me kërkesat diskriminuese të vendosura në DT dhe NJK i gjeni më poshtë:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2:

Përshtatshmëria profesionale:

4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe certifikuar me ISO standarte 9001- 2015; 14001-2015 ; 45001-2018 si dhe 50001-2018

Rekomandim: Të largoni nga kriteret e DT dhe NJK, ISO Standartet 50001 – 2018 – të cilat kanë të bëjnë me Sistemet e menaxhimit të energjisë.

Arsyetim: Standarti ISO 50001 – 2018 Fokusohet në menagjimin sistematik të energjisë brenda një organizate, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të efikasitetit energjetik, uljen e konsumit dhe ndikimin mjedisorë. Ky standart ka zbatim të drejtëpërdrejtë në strukturat dhe sistemet e brendshme të organizatave sic janë fabrikat dhe ndërmarrjet prodhuese. Në rastin e këtij projekti të ndërtimit të infrastrukturës rrugore, aktiviteti kryesorë është një projekt infrastrukturorë me natyrë të përkohshme, ku energjia nuk konsumohet dhe menaxhimi i energjisë nuk është aspak thelbësorë në jetën funksionale të një rruge. Andaj ne vlerësojmë që ky kriter është i pa nevojshëm dhe përdorimi i këtij standarti është jo efektiv dhe i pa justifikueshëm në këtë projekt.

Andaj rekomandojmë ta largoni nga kërkesat e Njoftimit të kontratës dhe DT si kriter.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kapaciteti teknik dhe profesional 8.1 & 8.2:

- 8.Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) - Nje eskavator me peshë max 5 T - Nje eskavator me peshe minimale 15 ton - Nje eskavator me zingjir gome dhe me lopat rrafshuse kapaciteti min 13 ton - Çekan pneumatic - Një kamion kiper me kran me pesh bartëse 8-12ton - Kamionët për transportin e dheut dhe zhavorit kapacitetit 12 m3(4 copë) - Nje rula hekur hekur me gjemba –pesha maksimale 2000kg - - Cilinder per ngjeshjen e tokes min 10 ton - Nje mineskavator me pesha maximale 1500 kg - Grejder per rrafshin e terenit dhe nivelizimin e tamponit min 12 ton. - Marrveshje per Furnzim me Zhavor, 8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje deshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . kopje te marrveshjes për furnizim me asfalt dhe zhavor të bashkangjitura me qertifikatën e biznesit, nr. fiskal, ndërsa për bazë të zhavor Licencë ose Leje të lëshuar nga Komisioni i Minierave - kopje

Rekomandim: Të largoni nga kriteret e DT dhe NJK,

1 Kamion me kran me peshë bartëse 10-12 ton,

1 Eskavator me zingjir gome dhe me lopatë rrafshuese kapaciteti min. 13ton

1 Kamionët për transport të dheut dhe zhavorit kapacitetit 12m3 (4 copë)

1 Cekan pneumatik

Rekomandim: Për arsye se të gjitha këto kërkesa për makineri janë diskriminuese për konkurrencën. Kamioni me kran dhe peshë bartëse 10-12ton nuk është i nevojshëm për asnjërin nga pozicionet e parashikuara në paramasën dhe parallogarinë e projektit andaj si kriter është i pa nevojshëm për këtë projekt.

- Eskavatori me zingjir gome dhe me lopatë rrafshuese kap. Min 13ton gjithashtu është i pa nevojshëm me të tilla specifika duke qenë se është diskriminues pasi që për të njejtën projekt është parashikuar edhe grejderi për rrafshim dhe nivelizim andaj është i pa nevojshëm si kriter. Andaj rekomandojmë që si kriter të kërkohet Eskavator me peshë min.13ton dhe jo me përshkrime të tilla të cilat nuk kanë rëndësi për projektin.

Kërkesa për kamion të kapacitetit 12m3 është e panevojshme dhe diskriminuese përcaktimi i kapacitetit fiks 12m3 duke mos vendosur maksimalja e lejuar ose minimalja. Andaj rekomandojmë të rregulloni kriterin duke vendosur min. 12 m3 ose max. 12 m3

1 Cekan pneumatik, sipas pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë nuk qëndron si pozicion në asnjërën pikë, andaj duhet larguar nga kriteret e DT dhe NJK.

Kapaciteti teknik dhe profesional

6.Një inxhinier i diplomuar i Mjedisit me 5 vite pervoj pune pas diplomimit, 6.Te ofrohen deshmi diplom univerzitare , cv-ja, kontrata e punëas ose marrëveshje me titull të tenderit mes dy palve për projektin konkret dhe certifica

Rekomandim: Të largoni nga kriteret e DT dhe NJK, inxhinierin e diplomuar të mjedisit me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. **Arsyetimi:** Duke qenë se është i panevojshëm si kriter.

U

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Diskriminimi në kritere, kështu duke i shkaktuar humbje kompanise sone ne aplikim te tenderit e cila rezulton ne humbje financiare duke mos kontraktuar projekte të reja me KK Drenas.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a. një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b. një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c. një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d. një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.